



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly

---

**LEGJISLATURA V**

Sesioni IV

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim  
Mbledhja nr. 13 .**

**Prishtinë, më 8.06.2015, në ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jasmina Živković, Agim Çeku, Mufera Sinik, Agim Kikaj, Fisnik Ismaili, Rrustem Berisha, Saša Milosavljević, Čerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

**Munguan:** Milka Vuletić dhe Slavko Simić.

**Nga pjesëmarrësit e tjerë:** përfaqësues nga OSBE-ja Ardiana Gashi, përfaqësues nga UNMIK-u Vlora Nushi, përfaqësues nga EUSR/EU Blerta Bejtullahu, përfaqësues të TV -21, TV- Rokum, RTK-21, Klan, përfaqësues të Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit – Celal Iliaz.

**Emrat e stafit mbështetës të komisionit,** Koorditore - Natasa Prica-Tishma, Zyrtare e lartë e fushës- Drita Çarkaxhiu.

**Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Živković,** kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportimi i ministrit lidhur me këto çështje:**

- politikat zhvillimore të MKK-së në integrimin e komunitetit pakicë në Kosovë,*
- ndarja proporcionale e fondeve për komunitete dhe*
- struktura e punësimit në MKK-në.*

**I ftuar: Ministri i ministris për Komunitete dhe Kthim, zot. Dalibor Jevtić.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

**Jasmina Živković** – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

## **2. Raportimi i ministrit për politikat zhvillimore të MKK-së në integrimin e komunitetit pakicë në Kosovë, ndarja proporcionale e fondeve për komunitete dhe struktura e punësimit në MKK-në**

**I ftuar: Ministri i ministris për Komunitete dhe Kthim, zot. Dalibor Jevtić.**

**Jasmina Živkovič** –fillimisht shprehu falenderim në përgjegjje të ftesës, ministrit zot, Dalibor Jevtić. Ajo ceku se Komisioni për të drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim është në procesin e monitorimit të Ligjit për shërminin civil të Republikës së Kosovës ku dhe ka formuar Grupin punues, në krye me Veton Berisha.

Fjalën ia dha ministrit, që në ta informon komisionin lidhur me përmbajtjen e raportit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

**Ministar Dalibor Jevtić** –Dëshiroj tu prezantoj disa informata më të rëndësishme lidhur me politikën zhvillimore të MKK në fushën e integritit të komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Vizioni ynë është që t'i kontribuojmë zhvillimit të shoqërisë multietnike dhe demokratike me të drejta të barabarta për të gjithë. Duhet të theksoj se MKK udhëhiqet me një parim themelor, që është transparenca. Ne bëjmë përpjekje që realizimi i qëllimeve strategjike të jetë i qasshëm për publikun e gjerë.

MKK ka zhvilluar Strategji për komunitete dhe kthim për periudhën 2014/2018. Ky dokument ka për qëllim arritjen e tri elementeve kyçe dhe këto janë: kthimi i qëndrueshëm, integrimi i të kthyerve dhe personave të zhvendosur dhe stabilizimi i të gjitha komuniteteve jo shumicë. Strategjia shërben si udhëzues në procesin e kthimit që përfshinë ndërtimin e njësive banesore, si dhe çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet publike, siç janë nxjerrja e dokumenteve personale, shërbimet mjekësore, çështja e sigurisë dhe liria e qarkullimit, qasja në arsim në gjuhën amtare, mundësia e punësimit dhe qasja në infrastrukturë. Konsideroj se ky është raport korrekt ndaj të gjithë atyre që e mbikëqyrin dhe përcjellin MKK, me ç' rast në mënyrë të thjeshtë të gjithë kanë mundësi që në fund të vitit ta vlerësojnë punën e institucionit.

Gjithashtu, është formuar Komisioni ndërministror për kthim, i cili më 15 maj ka mbajtur mbledhjen e parë të tij. Në të njëjtën mbledhje kemi nxjerrë vendime të caktuara që kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemeve të caktuara, para së gjithash lidhur me kthimin. Në procedurën e formimit të Komisionit ndërministror për çështjet e komuniteteve, i cili do të merret me çështjet e komuniteteve në Kosovë, kryesues i Komisionit duhet të jetë zëvendëskryeministri z. Branimir Stojanovic.

Ne planifikojmë hartimin e Projektligjit për personat e zhvendosur intern që do të merret me mbrojtjen juridike për kthim në kuptim afatgjatë. Dëshirojmë që të hartojmë Ligjin i cili do ti definojë të drejtat e të tjerëve. Kur është fjala për kthimin duhet të caktohen afatet kur do ta implementojmë kthimin e personave që dëshirojnë në mënyrë vullnetare të kthehen në Kosovë. Gjithashtu duhet tu sigurojmë të drejtën të gjithë atyre që ndoshta në këtë moment nuk dëshirojnë të kthehen në Kosovë për arsye të ndryshme, por gjithsesi këtë të drejtë mund ta realizojnë në momentin kur ata konsiderojnë se janë përmbushur kushtet për kthim të tyre të pa penguar. Njëherit, dëshirojmë të fillojmë me mbylljen e qendrave kolektive, si një çështje e rëndësishme, duke marrë parasysh kushtet në të cilat njerëzit sot jetojnë.

Ky projekt realizohet me ndihmën e Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë dhe misionit UNHCR në Kosovë, kur do ta fillojmë procesin e ndërtimit të njësive banesore për familje që i përmbushin të gjitha kushtet, ndërsa momentalisht jetojnë në qendra kolektive, në mënyrë që të ta zgjidhin problemin e banimit. Komuna e parë që do ta realizojë këtë projekt është Komuna e Shterpçës, në të cilën momentalisht gjendet qendra më e madhe kolektive me numrin më të madh të personave të zhvendosur internmbajt konferenca rajonale ne Shkup, e cila përfshin bashkëpunimin e qeverive të Malit të Zi, Maqedonisë, Serbisë dhe Kosovës, me qëllim të bashkimit të resurseve për krijimin e kushteve për kthimin e personave të zhvendosur, duke marrë parasysh se shumica e personave të zhvendosur gjenden në Serbi, Maqedoni dhe Malin e Zi. Në këtë konferencë janë definuar fushat e bashkëpunimit të mëtejshëm të cilat bëjnë përpjekje për ti implementuar.

Sa i përket ndarje proporcionale të fondeve për komunitetet jo shumicë, MKK nuk ka ndonjë kuotë të caktuar të ndarjes së buxhetit për komunitete. Parimi të cilin e kemi zbatuar është se në pajtim me buxhetin tonë i përgjigjemi kërkesave të komuniteteve jo shumicë në Kosovë. Për vitin 2015, MKK ka buxhetin prej 6,7 miliona euro, Për projekte të cilat 1 milion euro, për projekte të subfinancimit 500.000 €, për integrimin dhe stabilizimin e komuniteteve 1,9 milion euro, subvencionim 300.000€. Dëshiroj të theksoj se ne e kemi marrë vendimin e Qeverisë që mjetet e ndara për 4 komuna në Veri të Kosovës dhe kjo na ka krijuar në masë të madhe problem lidhur me projektet e planifikuara për këtë vit. Ne nuk jemi kundër investimit në cilëndo pjesë të Kosovës dhe jemi të gatshëm tu ndihmojmë qytetarëve të veri të Kosovës. Sipas raportit që e kemi marrë në këtë vit nuk do të ketë rishikim të buxhetit dhe nuk do të marrim mjete shtesë, që do të thotë se do të punojmë në kuadër të mjeteve që i disponojmë dhe ky është minimumi.

Një nga pyetjet ishte struktura e të punësuarve në MKK. Në këtë ministri 55% të punësuarave janë pjesëtarë të komuniteti shqiptarë, serbë 39%, boshnjakë 1%, turqë, 4%, goranë 1%, romë 1%. Në stafin politik kemi pjesëtarë të komunitetit malazez, por nuk kemi të punësuar nga komuniteti ashkalinj dhe egjiptian. Këto janë disa informata që kamë dëshiruar ti prezantoj dhe pres që edhe ju do të keni pyetje shtesë. Do të theksoja se pjesëtarët e komunitetit jo shumicë në Kosovë, e veçanërisht ju që jeni përfaqësues të këtyre komuniteteve duhet të kuptoni se MKK nuk është dhe nuk duhet të jetë adresë e vetme për çështjet e komuniteteve jo shumicë në Kosovë, nëse ekzistojnë ministrat e tjera dhe unë dëshiroj të ndihmoj që kërkesa e caktuar të dërgohet në adresë të duhur, nga se ne në të vërtetë nuk mund ti zgjidhim të gjitha çështjet. Ne nuk kemi mundësi ligjore e as financiare për ti zgjidhur të gjitha kërkesat.

**Jasmina Živković** – e hapi diskutimin për parashtrimin e pyetjeve të anëtarëve e Komisionit.

**Danush Ademi** – ishte falenderues për raportimin e ministrit, të cilin raport nuk e kemi pasur më herët dhe i cili është i një rëndësie të veçant për komunitetin jo shumicë.

Në bazë të raportit të ministrit dhe në bazë të strategjisë së komuniteteve dhe kthim për periudhën 2015-2018, vërehet se gjemi para një procesi të njejtë i cili nuk sjell ndryshime për komunitetin jo shumicë. Në bazë të statistikave të raportuara nga ministri, shifet kuart se nuk është specifikuar ndarja buxhetore sipas kërkesës së komunitetit jo shumicë, të cilën çështje e kemi ngritur edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Prej themelimit të MKK e deri më sot, kjo ministri disponon buxhet në vlerë deri në 100 milion euro, ndërsa shumë pak ka përfituar komuniteti ashkali apo thënë vetëm ndonjë familje. Në takimet e vazhdueshme me ish kryeministrin dhe me institucionet relevante janë diskutuar çështje të shumta dhe ndër temat më të rëndësishmet ishte sigurimi i mjeteve buxhetore për komunitetin jo shumicë. Si përgjigje ka rezultuar, se nuk janë planifikuar mjetet buxhetore për komunitetin jo shumicë.

Në kuadër të raportit të ministrisë, rezulton se është duke u zhvilluar vetëm procesi i kthimit prej vendeve të rajonit, nga Serbia, Mali i Zi, Maqedonia ndërsa nuk është ndërmarr asnjë iniciativë për vendet e treta.

Sa i përket çështjes së punësimit, theksoi se janë të kualifikuar një numër i konsiderueshëm i komunitetit ashkali ndësa atyre me vite nuk iu është mundësuar punësimi në institucione. Kjo çështje paraqet brengë të vazhdueshme për komunitetin tonë.

Njëherit përshëndet marrëveshjen politike të ministritë me rastin e emërimit të zëvendësministrit të komunitetit rom në këtë ministri. Me këtë rast, jemi me shpresë se do të ketë lëvizje në ngritjen e çështjeve, si në nivelet qendror ashtu dhe atë lokal.

Parashtroj pyetje, se cilat janë planet e ministrisë për hapje të konkursit për komunitetin ashkali, me qëllim që edhe ky komunitet të gëzojë të drejtat si shërbyes civil ?

**Veton Berisha** – ishte mirënjohës për pjesëmarrjen e ministrit në komision dhe shtoi se është caktuar takimi për ditën e sotme, me iniciativën e tij.

Njëkohësisht, shpreh shqetësimin e tij se mungon vullneti politik i ministritë lidhur me çështjen e punësimit, procesin e kthimit, ndarjen buxhetore, gjithnjë kur bëhet fjalë për komunitetin jo-shumicë . Në kuadër të procesit zhvillimor për komunitetin jo shumicë, përgjegjësia bie në Qeverinë e Kosovës, zyrën pran Kryeministritë, mirëpo adresa kryesore për ne është Ministria për Komunitete dhe Kthim.

Në fjalën e tij tha se edhe pas 16 viteve, shumë familje të komunitetit jo shumicë janë të pa strehuar dhe ende bredhin rrugëve të Kosovës. Si shembull muar rastin e lagjës kristal të Pejës, ku 300 familje të komunitetit egjiptian dhe disa familje të komunitetit romë kanë mbetur të pastrehuar e të cilët nuk kanë pasur përkrahjen e MKK. Kujdesi dhe strehimi për këto familje është bërë nga organizata e JOM-it. Përkatesisht për zgjedhjen e këtij problemi, propozoi që ministri personalisht të vizitoj këtë rajon për tu njihur për së afërmi me situatën dhe gjendjen e komunitetit në fjalë.

Në kuadër të procesit të kthimit, në vitin 2013 është marrë qëndrim për kthim kolektiv të shtatë familjeve, ndërsa nga ajo periudhë MKK nuk është ndërmarr asnjë veprim pozitiv nga ministria, për kthimin e familjeve tjera.

Është mirënjohës për iniciativën e ministritë, me rastin e formimit të komisionit ndërministror, ku tani jemi me shpresë se do të ketë zhvillim në procesin e kthimit dhe integritit të komunitit tonë.

Si çështje brengosëse për te është ndarja e fondeve brenda ministritë për një komunitet të caktuar, nga se ky proces paraqet diskriminim për komunitetin jo shumicë.

Andaj, propozim i tij ishte që ministri të ketë vullnet politik dhe të mos ketë ndarje proporcionale të fondeve, të përcaktuara me ligj. Gjegjësisht , ministria duhet të caktoj një linjë buxhetor në kuadër që të trajtohen njëjtë edhe komuniteti jonë, nga se jemi tatim pagues të rregullt si çdo qytetarë tjetër i Republikës së Kosovës.

Në vazhdimësi, tha se janë djegë shtëpitë e pesë familjeve në komunën e Gjakovës dhe se ende jetojnë në kontinier. Lidhur me këtë çështje është në dijeni edhe ministrit, por deri më sot nuk ka ndërmarr asnjë veprime konkret. Propozimi i tij ishte që ministri të gjej mekanizma adekuat në zgjedhjen e këtij problemi madhor.

Si kërkesë konkrete e tij ishte, që ministri të deklarohet se cili është vullneti i tij politik, lidhur me planet afatmesme apo afatgjate të ndarjes buxhetore për komunitetin ashkali, çështja e punësimit si dhe plani për investimin e shtëpive të komunitetit tonë.

**Jasmina Živković** – ka theksuar një fakt, MKK nuk është Ministri që merret vetëm me një komunitet, por kjo ministri merret me çështjen e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

**Fisnik Ismaili**, fillimisht paraqiti disa pyetjet për ministrin, e para , në bazë të raportit të ministritë tuaj rrjedh se përqindja e të punësuarve për komunitetin sërë është 90 % ndërsa 2 % për komunitetet tjera dhe kjo çështje është shumë diskriminuese për komunitetin pakicë. Pyetja është se cilat janë planet e ministritë për barazimin proporcional ndaj komunitetit jo shumicë ?

Bazuar në deklaratën e ministrit se është formuar një grup punues për rastet e ndërtimit të shtëpive të shqiptarëve në krojin e Vitakut, në mënyrë që ndërtimi i tyre të mos pengohet nga sërëbët lokal. Pyetja është, a ka filluar punën Grupi Punues dhe nga cilët zyrtar përbëhet ?

Pyetja e rradhës dhe më e rëndësishmja është se cilat janë planet e ministritë lidhur me procesin e kthimit të shqiptarëve në pronat e tyre në lagjet e veriut të Mitrovicës dhe në rrethina ?

**Ćerim Bajrami** – I ka falënderuar ministrit për pjesëmarrje dhe raportim lidhur me punën e MKK. Ai theksoi se situata në Lagjen e Boshnjakëve nuk është e kënaqshme lidhur me investimet për ndërtimin e shtëpive, por shpresoj se situata do të përmirësohet në të ardhmen. Do të pyesja lidhur me këto përqindje të punësuarave të komunitetit shqiptar dhe atij serb në raport me komunitetet e tjera jo shumicë në Kosovë. A ekziston mundësia që kjo të korrigohet gjatë punësimit të kuadrove të reja?

Pyetja e dytë e rëndësishme është se ne në këtë komision, me rastin e miratimit të buxhetit në vitin e kaluar, kishim iniciativë që të ndahen kodet për financim në mjedise të caktuara, përkatësisht financim për komunitete të caktuara. Ne mendojmë se ky propozim ishte i mirë dhe gjatë rishikimit të buxhetit duhet të ndahen këto kode.

**Agim Kikaj** - tha se është mirë të bëhet kapërcim i lëshimeve lidhur me administrimin dhe zbatimin e politikave që ka bërë kjo ministri. Në periudhën kur ka udhëhequr komisionin për komunitete dhe kthim në nivel lokal, njëjtë janë bërë lëshime për rastet e ndërtimit të shtëpive të rënuara. Konsideron, se jemi të thirrur që çështjet e planifikuara duhet të relaizohen me kohë.

Në kuadër të formimit të komisionit ndërministror, propozon që strukturimi i ri të mos jetë formal por të jetë në funksion të risive brenda ministrisë, me theks të veçantë të respektohen të drejtat dhe interesat e të gjitha komuniteteve, pa përjashtime.

Kur bëhet fjalë për ndarjen e fondeve është çështje e cila menagjohet nga vet ministria, gjithnjë e bazuar në ligj dhe për rastet me prioritet të cilat e kanë gjendjen e vështirë.

Në rastet kur ka mospërputhshmëri të administratës me merita, ishte i mendimit se duhet të ekzistoj mundësia e korrigjimit të planeve, brenda ministrisë.

**Agim Çeku**- përshëndet ministrin lidhur me zhvillimet e politikave, për realizim e strategjisë për komunitete dhe kthimi të qëndrueshëm.

Parashtroi disa pyetje për ministrin, theksoi se përveç MKK se ekziston edhe zyra për komunitete pranë zyrës së kryeministrisë e cila udhëheqet nga një përfaqësues i komunitetit serb, me ç'rast krijohet kopetenca të dyfishta, pyetja është a ka nevojë të jenë dy adresa?

Si çështje tjetër e rradhës, në kuadër të strategjisë, ministria juaj ka formuar komisionin ndërministror për integrimin e të kthyerve dhe personave të zhvendosur. Pyetja është se është planifikuar ndërtimi i një mekanizmi implementues për procesin e kthimit, ku duhet të merret parasysh rrethanat se a dëshirojnë të pranojnë kthimin e familjeve në rrethin e tyre ?

**Saša Milosavljević** – i shprehu faleminderit ministrit për pjesëmarrje në punën e Komisionit dhe e përgëzoi atë për punën e deritashme. Ai tha se do ta thekson një fakt, si grup parlamentar në mandatin e kaluar kanë dërguar kërkesa në të gjitha ministrinë për tu përgjigjur lidhur me numrin e të punësuarave nga radhët e komuniteteve në ato ministri. Gjithashtu sipas mendimit të tij MKK, e përmbush kuotën e parashikuar me ligj të përfaqësimit, kur bëhet fjalë për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë.

Ai ka folur edhe për kthimin e refugjatëve serb dhe është e njohur se vitin e kaluar në raporte është theksuar se ka pas kthim të komunitetit rom nga Mali i Zi. Duhet të merren parasysh të gjitha faktet dhe përfundimit të merren në mënyrë objektive, si dhe të gjitha çështjet që u janë drejtuar MKK-së duhet ti drejtohen edhe ministrive të tjera.

**Ministar Dalibor Jeftić**- duke i falënderuar për bashkëpunim me ministrin Predrag Boshković kemi arritur që personat e zhvendosur në Malin e Zi, të komunitetit rom, egjiptian dhe ashkali, përfundimisht që ta fitojnë mundësinë për zgjidhje afatgjate të çështjeve të tyre. MKK merret me zgjidhjen e problemeve të të gjithë popujve në Kosovë, pa ndarje selektive apo të ndonjë baze.

Kur bëhet fjalë për punësim, duke marrë parasysh ligjet, ministri i cilësdo ministrie, nuk merret me procesin e punësimit. Ministria e shërbimeve publike, në konsultim me sekretarët, dhe në kuadër të administratës dhe institucioneve të caktuara shpall konkurse. Ne jemi institucioni i vetëm në Kosovë, që e zbaton ligjin, në rast të punësimit të komuniteteve jo shumicë.

Sipas ligjit është parashikuar 10% të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në Kosovë, prandaj Ministria këtë fakt e ka respektuar.

Gjithashtu, kemi ndërmarr dhe iniciativën me Zyrën për komunitete pran zyrës së kryeministrit, me ndihmën e ambasadës Norvegjeze. Kemi krijuar një mekanizëm që përmes procesit të voluntarizmit ti hapim dyert dhe ti punësojmë pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, që nuk janë të përfaqësuar mjaftueshëm.

Lidhur me ndërtimin e shtëpive për të cilat foli z. Vetoni, duke marrë parasysh se me Vendim në nivelin lokal, këto shtëpi janë rrënuar deri sa njerëzit ishin duke jetuar në shtëpi, unë jam i mendimit se këtu nuk bëhet fjalë për kthim dhe konsideroj se në këtë nuk duhet ta bart përgjegjësinë për ndërtimin e këtyre shtëpive. Përgjegjësinë duhet ta bart ai që e ka krijuar këtë situatë. Lidhur me rastin e Lagjes Kroi i Vitakut, kemi formuar grupin punues në përbërjen e të cilit janë kryetarët e komunave, ministri Ljubomir Mariq dhe unë, nga dy përfaqësues të komuniteteve, përfaqësuesi i UNHCR-së, me mundësi të zgjerimit të këtij grupi. Ne dëshirojmë që në tre muajt e ardhshëm të sigurojmë kushtet që këta njerëz të kthehen dhe ti realizojnë të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë dhe ligj, pa marrë parasysh për të cilin komunitet bëhet fjalë. Gjithashtu, jemi duke punuar për kthimin e pjesëtarëve të komunitetit serb në fshatin Mushtisht afër Suharekës. MKK ka një qasje, ne i zgjidhim problemet, nuk i krijojmë. Sa i përket kodeve për komunitete, unë mendoj se kjo nuk është mënyrë e mirë e limitimit të mjeteve. Kjo do të na pamundësonte të veprojmë në mënyrë praktike dhe pragmatike. P.sh, në rast të një projekti të komunitetit boshnjak, ne do ta realizojmë dhe më pas, si ti përgjigjemi kërkesave të tjera që arrijnë. Konsideroj se më e rëndësishmja është që të angazhohemi me qëllim të jetës sa më të mirë të qytetarëve të Kosovës. Edhe njëherë do të theksoja se ne si MKK jemi gjithmonë të gatshëm për bashkëpunim.

**Jsmiina Živković** – duke i falënderuar ministrit, tha se ky takim u mbajt në kohën e duhur dhe se me përkrahjen e MKK-së do të punojmë në përmirësimin e pozitës së të gjitha komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

**Agim Çeku**- Në fjalën e tij tha se me strategji rregullohet çështja e kthimit, integritetit dhe stabilizimit të të gjitha komuniteteve pakicë. Sipas mendimit të tij kjo terminologji ka disa definicione. Sa i përket përvojës së tij ushtarake, tha se betejat janë të arritura të pashmangshme, si shembull muarr thënjen e z. Trazovic, ‘strategjia është arti i përdorimit të betejave për ta përfutur luftën’.

Për ta fituar këtë betejë, faza e parë është kthimi i qytetarëve shqiptar në Mitrovicën e veriut. Për të qen i sukseshëm procesi i kthimit dhe integritetit, sygjeroi që ju si ministër, kryetari i komunës së Mitrovicës së veriut, Ministri i Pushtetit Lokal, të keni biseda të vazhdueshme dhe të biden qytetarët shqiptarë që të kthehen në territoret e tyre.

**Agim Kikaj**- tha se ndoshta kishte keqkuptime në diskutimin e tij, nga se jemi të vetëdijshëm që çështjen e integritetit të komuniteteve do ti inicojmë edhe në ministrinë relevante.

Kërkesa e vetme është që ministria juaj të kujdeset me përgjegjësi për zbatimin e politikave në fushën e strukturës së punësimit.

**Fisnik Ismaili** – ishte i mendimit se përgjigjet e ministrit ishin të pjesërishme. Kur bëhet fjalë për strukturën e punësimit, mendon se përgjegjësia nuk bie vetëm në këtë ministri, nga se të njëjtën çështje do ngrisin edhe në ministrinë relevante. Mirëpo kërkon informata shtesë lidhur me planet e ministrisë për zbatimin e kuotës së 10 %, me arsye të mos diskriminimit të komunitetit jo shumicë.

**Veton Berisha** – E vlerëson vullnetin politik të ministrit për kontributin e dhën për stabilizim të situatës ekonomike. Por ajo çka e shqetëson më së shumti është mos interpretimi i drejtë i nenit 10, të ligjit për Shërbyes Civil. Ai nuk pajtohet me përqindjen proporcionale të përfaqësimit të komunitetit jo shumicë. Në fjalën e tij tha se me rastin e ndarjes së ministrive, ku përfaqësimi i takon ministrisë së komunitetit turk përqindja është 14%, në ministrinë për komunitete 39 %.

Andaj, interpretimi i tillë nuk përmbush 10% e vendeve të punës për përfaqësues të komuniteteve tjera e të cilët i përmbushin kriteret e theksuara me ligj.

Si kërkes e tij konkrete ishte që ministri të ketë vullnet politik dhe shqetësimet tona ti paraqet edhe në ministrinë gjegjëse lidhur me përfaqësimin e komunitetit pakic.

**Danush Ademi** - jemi në dijeni se kjo ministri nuk është qendër e punësimit nga se përgjegjës janë edhe ministrin tjera.

Ai shtoi se sipas ndarjes së ministrive, në kry me ministrin e komunitetit serb, boshnjak dhe atij turk shifet se zbatohet 10%, ndërsa në anën tjetër ballafaqohet me një realitet të kundërt dhe diskriminues komuniteti jo shumicë. Në kuadër të këtij problemi, kërkesa jonë është që të ndrohet strategjia. Nëse pas rishikimit të buxhetit nuk do të ketë ndryshime, atëher GP 6+ do të dal me këkesë në formimin e kodit të veçantë, për komunitetin jo serb .

**Ćerim Bajrami** – ai e ka informuar ministrin me një dukuri brengosëse dhe kjo është se në vendet e rezervuar për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë punësohen pjesëtarët e komunitetit shqiptar me deklaratë të rrejshme se i përkasin një komuniteti tjetër jo shumicë. Kemi formuar grupin punues për mbikëqyrjen e ligjit për shërbyesit civil dhe dëshiroj që këtë problem ta ngriti në nivel më të lartë dhe të gjitha këto në pajtim me mundësitë e deputetëve. Ju faleminderoj për prezencën dhe shpresoj se do të bashkëpunojmë edhe në të ardhmen.

**Ministar Dalibor Jeftić** – në fund do të them se ne nuk zhvillojmë politikën e transferimit të problemeve, në çdo kuptim. Ne dëshirojmë që në procesin e zgjedhjes së problemeve ti përfshijmë të gjitha institucionet dhe individët. Ju falënderoj për mundësinë e dhënë për tu përgjigjur në pyetjet e juaja dhe gjithmonë do ti përgjigjem ftesës suaj. Siç thash, puna e MKK është transparent dhe gjithmonë jemi të hapur për bashkëpunim me të gjithë dhe gjithmonë do të mbetet kështu deri sa jam në krye të këtij institucioni.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:30**

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetare e Komisionit**

---

**Jasmina Živković**